



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:182783

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05521908

P.nr.2021:182784

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Adem Shabani me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të pandehurit, A.E., me vendbanim në Ferizaj rruga ... nr....., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par 1 KPRK-së, akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm së PP/II.nr.1252/2021 e datës 17.08.2021, duke vendosur lidhur me Marrëveshjen e Ndërmjetësimit ND.nr.../2024, të datës 01.02.2024, të lidhur në mes të pandehurit A.E. dhe të dëmtuarit E.E., me vendbanim në Ferizaj, rruga "...", nr... në bazë të nenit 229, 357, par.1, pika 1.3, të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr.08/L-032 dhe nenit 2, par.2, nenit 8 ,14 dhe nenit 15, par.1, të Ligjit mbi ndërmjetësimin, Nr.06/L-009, të datës 23 Korrik 2018, pas pranimit të Marrëveshjes së Ndërmjetësimit, jashtë seancës gjyqësore me datën 04.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.nr.../2024, të datës 01.02.2024, e lidhurnë Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të ndërmjetësuesit Sh.R., të pandehurit A.E. dhe të dëmtuarit E.E..

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1252/2021 e datës 17.08.2021, dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit A.E., me vendbanim në Ferizaj rruga ... nr....., i lindur më ... në Ferizaj, nga babai J. dhe nëna N., mbiemri vajzërisë T. ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..., tel.04...- për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par 1 KPRK-së.

- **III.** Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet e gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1252/2021 e datës

17.08.2021, kundër te pandehurit A.E., me vendbanim në Ferizaj rruga ... nr...., për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par 1 KPRK-së.

Gjykata, me datën 01.02.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me pjesëmarrje e prokurorit të shtetit Alber Zejnullahu, të pandehurit A.E. dhe të dëmtuarit E.E..

Gjyqtari i vetëm gjykues në fillim të shqyrtimit fillestar i ka njoftuar palët pjesëmarrëse se bazuar në Nenin 229 paragrafi 1 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale nr.08/L-032) thuhet; ” Para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit mund ta dërgojë kallëzimin penal për një vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet për ndërmjetësim.

Pas ngritjes së aktakuzës, me miratim të prokurorit, të dëmtuarit dhe të pandehurit apo gjyqtari i vetëm gjykues mund ta referoj çështjen, për këto vepra në ndërmjetësim. Para se ta bëjë këtë, prokurori i shtetit apo gjyqtari i vetëm gjykues merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij dhe nëse ndërmjetësimi është në interes të të dëmtuarit ose viktimës.

Gjithashtu edhe me neni 2, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në një (1) vjet, në rastin konkret veprat penale për të cilat akuzohet i pandehuri Sulm nga neni 184 par 1 KPRK-së, i është përcaktuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit. Kurse me nenin 8, paragrafi 7, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se pranohet marrëveshja në mes palëve për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, në çdo fazë të zhvillimit të procedurës në gjykatë kompetente, apo në një organ tjetër kompetent.

Pas njoftimeve të lartë cekura gjykata në fillim ka marrë mendimin e të dëmtuarit, prokurorit të shtetit, të pandehurit ku kanë deklaruar veç e veç se pajtohen për referimin e rastit në Qendrën e Ndërmjetësimit për përfundimin e këtij rasti, ku gjykata ka aprovuar propozimin në fillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe këtë lëndë penale e ka dërguar në procedurën e ndërmjetësimit.

Gjykata Themelore në Ferizaj, ka pranuar Marrëveshjen e Ndërmjetësimit me datën 01.02.2024, ku palët kanë arritur pajtimin në ndërmjetësim ashtu që janë marr vesh që çështja të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, të cilën marrëveshje e kanë nënshkruar dhe e njëjta nga ndërmjetësuesi është proceduar në gjykatë për aprovim të marrëveshjes.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoj se

palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësit, andaj edhe gjykata të njëjtën e aprovoi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjykata vlerëson se me arritjen e marrëveshjes së ndërmjetësit në mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar është krijuar rrethanë që e pengon ndjekjen penale në kuptim të nenit t 357, par.1, pika 1.3, të KPP-së.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale ka vendosur në bazë të nenit 453 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Nr.08/L-032.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.2021:182784 i datës 04.03.2024

Zyrtare ligjore

Arbelinda Tahiri

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda pesë (5) ditësh nga koha e dorëzimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.